



GS1 ALBANIA – DEKLARATE MBI POLITIKAT E PRIVATESISE

Në këtë deklaratë paraqitet mënyra se si kryhet mbledhja dhe përdorimi i informacionit privat nga GS1 Albania si dhe të drejtat tuaja për të aksesuar dhe korrigjuar atë informacion. GS1 Albania rekomandon që ta lexoni me kujdes dhe ta përdorni për referencë në të ardhmen.

OBJEKTI I KËSAJ RREGULLOREJE

Kjo Rregullore ka për objekt informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë që janë marrë për të dhënat e tyre nga organizata GS1 Albania.

Bazuar në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,
- Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008 'Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale',
- Ligjin Nr.9918 datë 19.05.2008 'Për Komunikimet Elektronike dhe Postare' si dhe aktet e tjera nënligjore në plotësim.

Administratori i faqes (GS1 Albania), kryen përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

MBROJTJA E TË DHËNAVE

Mbrojtja e të dhënave bazohet në:

- Përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- Grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- Mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- Saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe, kur është e nevojshme, duhet të përditësohen duhet ndërmarrë çdo hap i arsyeshëm për të fshirë apo korrigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej;
- Mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.



TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

- E drejta për akses

1. Çdo person ka të drejtë që pa pagesë me kërkesë me shkrim, të marrë nga kontrolluesi:

- konfirmimin nëse të dhënat personale po i përpunohen ose jo, informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale;

- në një formë të kuptueshme, të dhënat personale dhe informacionin e disponueshëm për burimin e tyre;

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

Kontrolluesi

GS1 Albania

Rruga e Barrikadave

1001 Tiranë, Shqipëri

Web: www.gs1al.org

- E drejta për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen

1. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave pa pagesë, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo të fshirjes.

3. Kur kontrolluesi nuk bën bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te komisioneri.

PËRHAPJA DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

GS1 Albania e respekton plotësisht privatësinë tuaj dhe nuk i transmeton të dhënat tuaja personale palëve të treta, me përjashtim të rasteve kur është dhënë pëlqimi juaj shprehimisht për një gjë të tillë.

Informacioni Personal që ruhet nga GS1 Albania mund të përfshijë emrin tuaj, adresën e tanishme dhe të mëparshme, numrat tuaj të telefonit, adresën e e-mail-it, numrin e llogarisë bankare të subjektit dhe pozicionin e punës.



MASAT E SIGURISË NË LIDHJE ME TË DHËNAT PERSONALE

GS1 Albania, është e ndërgjegjshme për rëndësinë dhe sensitivitetin e të dhënave personale dhe respekton në mënyrë rigorozë masat për sigurinë që parashikohen në Ligjin Nr 9887 datë 10.03.2008 'Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale'. Kjo arrihet nëpërmjet përdorimit të teknikave të avancuara dhe moderne për të ruajtur bazat e të dhënave dhe sistemet e saj kompjuterike. Po ashtu, GS1 Albania kujdeset që transferimi dhe regjistrimi i të dhënave të bëhet me masa të plota sigurie në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës.

Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë për të arritur mbrojtjen e të dhënave personale nuk përfshin lidhjet midis kësaj faqeje dhe faqeve të tjera. Ne ju inkurajojmë të lexoni deklaratat e privatësisë në faqet e tjera të internetit që ju vizitoni pasi kushtet e këtyre faqeve mund të ndryshojnë nga ato të GS1 Albania.

PYETJE APO ANKESA

Me anë të shpjegimit të mësipërm, GS1 Albania shpreson t'ju ketë informuar saktësisht dhe në mënyrë të plotë rreth çështjeve të privatësisë suaj.

Nëse keni pyetje, ankesa/kërkesa, ose vërejtje rreth këtyre çështjeve, mos hezitoni që të na kontaktoni në adresën e mëposhtme:

Kontrolluesi

GS1 Albania

Rruga e Barrikadave
1001 Tiranë, Shqipëri
web: www.gs1al.org

E DREJTA PËR TU ANKUAR

Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë.

Komisionieri për Mbrojtjen e të dhënave

Rruga "A. Toptani", Kati II-të.
<http://www.idp.al>

Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.



TË TJERA

Kjo rregullore duhet kuptuar në përputhshmëri me Kushtet e Përgjithshme të kësaj faqeje.

GS1 Albania rezervon të drejtën që të ndryshojë apo modifikojë këtë rregullore në çdo moment, në zbatim të çdo ndryshimi të mundshëm të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë.